

DALLIMI MIDIS GODITJEVE TË  
KËRKESËS DHE OFERTËS NË  
TREGUN SHQIPTAR TË KREDISË  
DUKE PËRDORUR NJË METODË  
VROJTIMI: CILA PREJ TYRE  
NDIKON MË SHUMË KREDINË  
BANKARE PËR BIZNESET (DHE  
INDIVIDËT)?

Gerti Shijaku

AMBERAL SYNDICOR



BANKA E SHQIPËRISË

**Gerti Shijaku**

Banka e Shqipërisë, Departamenti i Kërkimeve

E-mail: [gshijaku@bankofalbania.org](mailto:gshijaku@bankofalbania.org)

***Shënim:** Për arsye të terminologjisë së përdorur, studimi i plotë është në gjuhën angleze. Ndërkohë në vijim gjeni një përmbledhje ekzekutive të tij.*

© Banka e Shqipërisë.

## **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

*Ky punim synon të analizojë një çështje kyçe që lidhet me nevojën për të kuptuar nëse dhe në çfarë mase kreditimi bankar në Shqipëri përcaktohet nga faktorë të lidhur me kërkesën apo të lidhur me ofertën. Ai hulumton shkallën përmes të cilës faktorët e lidhur me kërkesën, duke përcaktuar aftësinë dhe dëshirën e huamarrësve për të kërkuar më shumë kredi, nxisin flukset e kreditimit bankar. Ose në të kundërt, faktorët e lidhur me ofertën dhe çështje të tjera të bilancit kontabël të bankave përcaktojnë shkallën me të cilën bankat, duke shtrënguar standardet dhe kushtet e tyre të kreditimit, dëmtojnë ofertën e huadhënies bankare. Për t'i identifikuar këto goditje, mbështetemi në informacionin e përftuar nga të dhënat e marra nga Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues, në rastin e Shqipërisë, i cili ofron një përjasje të përsosur metodologjike për të dalluar dhe identifikuar efektet e goditjeve të shkaktuara nga faktorët e lidhur me kërkesën dhe ata me ofertën. Goditjet e lidhura me këta faktorë janë analizuar, më pas, duke pasur në fokus efektin e tyre në huadhënien bankare ndaj bizneseve (dhe individëve). Përjasja e vlerësimit empirik përfshin metodën e vektorëve autoregresivë sipas kufizimit të shenjës. Kampioni përfshin të dhëna tremujore për periudhën T4 2007 – T4 2018. Ai kombinon tregues makroekonomikë dhe tregues të lidhur specifikisht me bankat, duke përfshirë edhe informacionin nga vrojtimi i aktivitetit kreditues të bankave.*

